



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 06/L-143

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVËSHJES SË KREDISË NË MES
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG SI
HUADHËNËS LIDHUR ME FINANCIMIN E PROJEKTIT NDËRTIMI I
SISTEMIT TË FURNIZIMIT ME UJË PËR KOMUNËN E GRAÇANICËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVËSHJES SË KREDISË NË MES
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG SI
HUA DHËNËS LIDHUR ME FINANCIMIN E PROJEKTIT NDËRTIMI I
SISTEMIT TË FURNIZIMIT ME UJË PËR KOMUNËN E GRAÇANICËS**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë marrëveshjen për kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për projektin për ndërtimin e sistemit të ujësjellesit për komunën e Graçanicës.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Nëpërmjet këtij Ligji ratifikohet Marrëveshja për kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për projektin për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për komunën e Graçanicës.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Shtojcën e këtij Ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja për kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për projektin ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për komunën e Graçanicës.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L-143
30 janar 2019

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI